

## PËLQIM PËR DHËNIEN, RUAJTJEN, PROCESIMIN DHE TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Kjo formë e pëlqimit është e përgatitur nga SIGAL UNIQA Group Austria. Për qëllime të këtij pëlqimi subjekt i të dhënave është nënshkruesi i kësaj forme ndërsa Sigal Uniqa është marrës dhe përpunues i të dhënave.

Unë deklaroj, me vullnetin tim të lirë jap pëlqimin tim të pakushtëzuar dhe shprehimor që Kompania e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. të marrë, ruajë, përpunojë, procesojë dhe transferojë të dhënat e mia personale dhe të dhënat e ndjeshme personale (biometrike, gjenetike, shëndetësore) në formë elektronike dhe/ose fizike për qëllimet si në vijim:

- Për të gjithë procesin marrjes në sigurim dhe shitjes, si dhe lëshimin e policës/ave të sigurimit dhe menaxhimin e policave të mia të sigurimit; si dhe procesin e mëvonshëm në rast të aplikacioneve të reja nga ana ime për produktet e sigurimit;
- Për trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dëmshpërblim, duke përfshirë marrjen e informacionit lidhur me të dhënat e mia personale dhe ato të ndjeshme personale të nevojshme për trajtimin e kërkesave të mia për dëmshpërblim nga palë të treta që disponojnë këto të dhëna si për shembull: institucione mjekësore/shëndetësore, kompani të tjera të sigurimeve në Kosovë dhe jashtë Kosovës pa kufizim, kompani të ndryshme të shërbimeve dhe asistencë si vlerësues të licencuar për ekspertiza dhe të tjera;
- Për qëllime tjera sigurimi, për qëllime risigurimi dhe qëllime statistikore nga SIGAL UNIQA.

Konfirmoj se jam informuar dhe njoftuar që SIGAL UNIQA do të mbledhë, ruajë, përpunojë dhe transferojë të dhënat e mia personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Të drejtat e mia personale siç janë: e drejta të njihem me të dhënat e mia personale dhe të dhëna të ndjeshme personale; e drejta ime për qasje të pakufizuar në të dhënat e mia personale; e drejta për të korrigjuar, ndryshuar dhe/apo fshirë (harruar) të dhënat e mia personale; e drejta për kufizimin e të dhënave të mia personale; e drejta për tu njoftuar për shkeljen të të dhënave të mia personale; e drejta që të njoftohem për transferimin e të dhënave; e drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale ose vendimmarrjen e automatizuar nga SIGAL UNIQA; e drejta që të kërkoj sqarime dhe informacione nga Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave pranë SIGAL UNIQA; e drejta për paraqitjen e ankesës në Agjencinë për Informim dhe Privatësisë, e drejta që në çdo kohë të tërhiqem nga pëlqimi i dhënë, më janë njoftuar dhe komunikuar qartë nga SIGAL UNIQA si të drejta të garantuara me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pa paragjykuar të drejtën time për tërheqje nga ky pëlqim, unë me vetëdije të plotë e kuptoj dhe pajtohem që tërheqja nga ky pëlqim në asnjë formë nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave të mia personale të kryera para tërheqjes së këtij pëlqimi. Andaj konfirmoj me vetëdije të plotë se çfarëdo përpunimi i tillë i të dhënave të mia personale dhe të ndjeshme personale ngelet me efekt të plotë juridik dhe i pakthyeshëm.

Pajtohem që SIGAL UNIQA të kryej marketing dixhital të drejtpërdrejtë për produktet dhe shërbimet në çdo kohë dhe për të më kontaktuar përmes postës, telefonit, SMS-ve, postës elektronike ose mjete të tjera.

Përfundimisht, me nënshkrimin e këtij pëlqimi, unë e konfirmoj që e kam lexuar me vëmendje dhe kam kuptuar në tërësi përmbajtjen e këtij pëlqimi, dhe me vullnet të plotë e të shprehur lirshëm. Çdo çështje, pakënaqësi ose shqetësim në raport me të dhënat personale mund të adresohen në çdo kohë përmes adresës elektronike: [info@unika-ks.com](mailto:info@unika-ks.com).